AKT NORMATIV
Nr.2, datë 10.11.2005

PËR LEJIMIN E KESH, SHA-SË, TË MARRË PJESË NË ANKANDET E BLERJES SË KAPACITETEVE TRANSMETUESE DHE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Lejimin e KESH, sha-së të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese, për transmetimin e energjisë elektrike, sipas kërkesave dhe procedurave të kërkuara nga shoqëritë, që organizojnë këto ankande apo shesin kapacitete transmetuese.

Neni 2

Lejimin e KESH sha-së, të marrë pjesë në ankandet për blerjen e energjisë elektrike, sipas kërkesave dhe procedurave të kërkuara nga shoqëritë, që organizojnë këto ankande apo shesin energjinë elektrike, për sasinë deri në 600 milionë kwh në vit.

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha